

VENDIM
Nr. 81, datë 31.5.2019

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “S G D ENERGJI” SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “NDËRFUSHAS” ME FUQI TË INSTALUAR 1125 *kw*

(Ndryshuar me Vendimin nr. 37, datë 27.03.2024)

(I përditësuar)

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “a”; nenit 5, pika 1, germa “a”; nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimi, transferimi, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”; si dhe nenit 15 të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.5.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, lidhur me licencimin e shoqërisë “S G D ENERGJI” sh.p.k, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Ndërfushas”, me fuqi të instaluar 1125 kw,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 57, datë 15.4.2019–2.2019, ka filluar procedurën për licencimin e shoqërisë “S G D ENERGJI” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje, ERE me shkresën nr. 32/16 prot., datë 15.4.2019, ka kryer njoftimin në median e shkruar, si dhe me shkresën nr. 250/1 prot., datë 17.4.2019 ka përcjellë pranë shoqërisë “S G D ENERGJI” sh.p.k. njoftimin e vendimit të fillimit të procedurës, si dhe mungesën e dokumentacionit të kërkuar.

- Shoqëria “S G D ENERGJI” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 205/2 prot., datë 2.5.2019, ka paraqitur një pjesë të dokumentacionit të munguar. Në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimi, transferimi, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit nr. 109, datë 29.6.2015 nuk rezultoi të këtë ndonjë vërejtje apo ankesë nga palët e treta lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “S G D Energji” sh.p.k.

- Aplikimi i shoqërisë “S G D Energji” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimi, transferimi, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë vijon:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1; gjerat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f” dhe “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për HEC (neni 9, pika 4.1.1; pika 4.1.2; pika 4.1.3, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”; pika 4.1.4, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”; pika 4.1.5, gjerat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Shoqëria “S G D Energji” sh.p.k., mbështetur në pikën 2, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe VKM nr. 822, datë 7.10.2015 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncensionit”, i ndryshuar, ka aplikuar në MEI dhe është pajisur me miratimin përfundimtar nr. 2549/13 prot., datë 9.10.2017, për ndërtimin e hidrocentralit “Ndërfushas”, me kapacitet 1125 kw, që shfrytëzon ujërat në rrjedhën e mesme të përroit të Sharrës dhe Përroit të Zhavorreve, degë e përroit të Lenës, degë e lumit Mat, Bashkia Bulqizë, qarku Dibër.

- Shoqëria “S G D Energy” sh.p.k ka depozituar kontratën e qirasë me nr. 142 prot., datë 15.9.2017 “Për dhënien në përdorim të sipërfaqes së zonës së mbrojtur” të lidhur midis Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Shoqërisë S G D Energy sh.p.k për dhënien me qira të shpërfaqjes prej 1754 m², e cila ndodhet në zonën e Mbrojtur Mali me Gropa Bizë, Martanesh, të ekonomisë pyjore/kullimore Ballenjë. Afati i kësaj kontrate do të jetë 5 vjet (nga data 15.9.2017 deri në datën 14.9.2022) me të drejtë rinovimi në zbatim të dispozitave të legjislacionit në fuqi, të drejtave dhe

detyrimeve të ndërsjella, kushteve të përcaktuara në këtë kontratë ndërmjet palëve, si dhe koordinatave përkatëse të kufijve, që përcaktojnë këtë sipërfaqe.

- Shoqëria ka paraqitur lejen e Këshillit të Basenit Ujor Mat, “Për përdorim të burimit ujor”, dhënë me vendimin nr. 10, datë 27.4.2017, e vlefshme, për periudhën nga data 27.4.2017 deri 27.4.2022. Kjo leje është dhënë me qëllim ndërtimin e HEC “Ndërfushas”, duke përdorur burimin ujor të përroit të Sharrës, degë e lumit Mat.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “SGD ENERGJI” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Ndërfushas” me fuqi 1125 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. *Shfuqizuar.*

3. *Shoqëria “SGD Energji” sh.p.k. të depozitojë në ERE lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjie nga HEC “Ndërfushas” brenda datës 13.12.2027.*

4. *Në rast se shoqëria “SGD Energji” sh.p.k. nuk depoziton në afat lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujor, sikurse përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi, dhe ka një urdhër për ndërprerjen e aktivitetit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT), atëherë nuk ka të drejtë të operojë/ushtrojë veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.*

5. *Ky vendim është objekt rishikimi në varësi të plotësimit të kushtit të lënë në pikën 3.*

Në rastin e mospërmbylljes së kushteve të parashikuara në pikën 2 dhe 3 të këtij vendimi nga ana e shoqërisë, ky vendim është objekt rishikimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti